



Breaking News:

DVP Korçë, gjatë 24 orëve të fundit



Lajmet

Operacionet

02/09/2024

Tiranë – Finalizohet Nga Komisarjati I Policisë Nr. 2, Operacioni Policor I Koduar “Room”

Tiranë

Finalizohet nga Komisarjati i Policisë Nr. 2, operacioni policor i koduar “Room”, ndjekur me metoda speciale të hetimit, për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje.

Arrestohet në flagrancë një 33-vjeçar, që posedonte lëndë të dyshuar narkotike kokainë dhe armë zjarri pistoletë.

Shërbimet e Komisarjatit të Policisë Nr. 2, në vijim të punës për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin e koduar “Room”.

Si rezultat i këtij operacioni u arrestua në flagrancë shtetasi K. A., 33 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 242, 278dhe 283 të Kodit Penal.

Shërbimet e Komisarjatit të Policisë Nr. 2, kanë ushtruar kontroll në një dhomë hoteli në Rugën e Kavajës, në të cilën akomodohej shtetasi K. A. Ky shtetas gjatë ndërhyrjes, nuk i është bindur urdhrave të punonjësve të Policisë. Gjatë kontrollit të dhomës, u gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, sasi lëndë të dyshuar narkotike kokainë dhe një armë zjarri pistoletë me krëhër e municion luftarak.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON

Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Mirditë – Identifikohet autori i dyshuar i kultivimit të 60 bimëve narkotike, në fshatin Lajthizë

Vlorë/Kundërshtuan me forcë punonjësit e Policisë, identifikohen dhe shpallen në kërkim 3 shtetas ▶